

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRIMIN
Ref./B. Nr. 132
Data/Date: 16. 04. 2026



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 13.02.2026, në ora 10:00h, në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Filloreta Musaj, Rrahim Sogojeva, Dardane Sogojeva Shala, Ali Ismaili dhe Vildane Latifi.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Valon Prebreza - Kryetar i Komunës, Izja Mjeku - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis dhe Resul Makreshi - Drejtor për Teknologji Inovacion dhe Integritim Evropian.

Të tjerë: Lindita Dervisholli Prebreza - Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore dhe Valentin Krasniqi - Udhëheqës i Sektorit për Pronë.

REND DITE

1. Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë.
2. Propozim për shpalljen e interesit publik për Ngastrat Kadastrale në Zonën Kadastrale të territorit të Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Propozim për ndihmë financiare të fëmijëve me autizëm dhe sindromin down.
4. Raporti i Auditimit të jashtëm për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024.
5. Raporti i Auditimit të performancës në procesin e lejeve ndërtimore në Komunën e Fushë-Kosovës.
6. Informatë për Performancën Komunale në vitin 2024.
7. Propozim për shqyrtimin e Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.
8. Propozim për themelimin e Komitetit për Komunitete.
9. Propozim për themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik.
10. Propozim për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Kadastër Shërbime Publike dhe Mbrojtje e Mjedisit.
11. Propozim për themelimin e Komitetit për Arsimit Kulturë Rini dhe Sport.
12. Propozim për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
13. Propozim për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra.
14. Propozim për shqyrtimin e Kërkesës Nr. 01-104/02-0004317/26, të datës 10.02.2026 për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2026.
15. Propozim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
16. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani kjo është mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa, pas konfirmimit të ligjshmërisë së vendimit Nr. 13, të datës 28.01.2026, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, andaj ju dëshiroj sukses dhe punë të mbarë, juve anëtarëve të komitetit, ku Lidhja Demokratike e Kosovës, nuk ishte bashkëpunuese në mbledhjen e kaluar të Kuvendit të Komunës, të mbajtur me datën 22.01.2026, synimi ynë ishte që të kemi një gjithëpërfshirje. Hap diskutimin për rendin e ditës.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje, tani unë kërkoi që tek Komiteti për Planifikim Urban, të përfshihet edhe fusha e Infrastrukturës.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne duhet të pajisemi me letra, ashtu si duhet, të kemi materialin me ngjyra, jo kështu, në mënyrë që të jemi të përgatitur dhe të kemi një performancë të mirë, të kemi mendimin tonë kritikë për secilin propozim, çështjet dhe propozimet e mira për qytetarë do t'i përkahim secilën herë, gjatë katër viteve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pajtohem me kritikën e parafolësit tim, keni të drejtë, që materiali duhet të jetë i plotë dhe i lexueshëm, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, do të ju pajisim me ngjyra për pjesën grafike të materialit për shqyrtim, kërkojmë nga Drejtori për Teknologji Inovacion dhe Integritim Evropian, që të punon për hapjen e emailave zyrtare dhe trajtimin dinjitoz të secilit anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Drejtori për Teknologji Inovacion dhe Integritim Evropian: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam vetëm një person IT, edhe ai tani është në pushim mjekësorë, ka paralajmëruar, se do të marrë një vitë pushim pa pagesë, por unë do të angazhohem, që të rregullojmë këto punë, sepse kjo punë është e ndërlikuar, edhe me Agjensinë e Shoqërisë së Informacionit.

Ali Ismaili: Një zyrtar i IT, nuk mund të kryen të gjitha këto punë, por ne kërkojmë që ju ta zgjidhni, sa më shpejtë këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës sqaroi se e kemi edhe një pikë shtesë: Propozimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Fushë-Kosovës, për mandatin zgjedhor 2025-2029.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa e aprovuan rendin e ditës me pikën shtesë: Propozimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Fushë-Kosovës, për mandatin zgjedhor 2025-2029.

Pika e parë (1) - Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtimin e 'Propozimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë', ftoi Zyrtarin z. Valentin Krasniqi që të na jap sqarime.

Valentin Krasniqi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Sqaroi se lokacioni për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, përfshinë tre ngastra kadastrale, me sipërfaqet e evidentuara në këto ngastra kadastrale.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes vetëvendosje, pajtohem që propozimi në fjalë, të procedohet për shqyrtim në kuvendin e Komunës.

Ali Ismaili: Ne kërkojmë që të kemi pjesën grafike që shihet qartë, sepse në letra shkruan rruga 'Tahir Zemaj', ndërsa në fakt është rruga 'E Pejës', ta dijmë saktë distancën e zonës, ku pritet të ndërtohet objekti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, të kemi sqarime shtesë nga Drejtoresha znj. Albana Gashi, Drejtori z. Remzi Shala, materiali duhet të jetë i kompletuar.

Pati edhe diskutime dhe sqarime tjera për zonën në fjalë, pas të cilave Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë'.

Pika e dytë (2) - Propozim për shpalljen e interesit publik për Ngastrat Kadastrale në Zonën Kadastrale të territorit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shpalljen e interesit publik për Ngastrat Kadastrale në Zonën Kadastrale të territorit të Komunës së Fushë-Kosovës'. Hap diskutimin.

Ali Ismaili: Edhe këtu janë vërejtjet e njëjta, mungojnë materialet për vendet ku ndodhen këto prona, në aspektin zyrtar, sepse ne mund të shikojmë në gjeo-portal, por duhet të kemi këto materiale, ku pritet të realizohen shumë projekte kapitale publike.

Valentin Krasniqi: Këto prona janë nën menaxhimin e Agjensisë Kosovare të Privatizimit, në të gjithë territorin e komunës, tani vetëm shpallen si prona me interes të përgjithshëm publik, do t'ua japim.

Ali Ismaili: Ne duam dhe kemi të drejtë të dijmë, secilin lokacion të këtyre pronave, kemi të drejtë ligjore ta kemi listën e pronave komunale, këtë unë e kam kërkuar përmes 'Kërkesës për qasje në dokumente zyrtare për pronat komunale' dhe nuk e kam marrë, kjo listë nuk është as në ueb-faqën e komunës, në të kaluarën për këtë punë komuna, ka marrë dënime me mijëra euro nga Agjencia për Informacion dhe Privatësi.

Vildane Latifi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pajtohem me parafolësin tim, që ne duhet të kemi informata të plota për pronat komunale, por edhe për këto prona nën menaxhimin e Agjensisë Kosovare të Privatizimit, që po i shqyrtojmë tani, materiali duhet të jetë i plotësuar, po ashtu edhe qasja e trajtimit të propozimeve, me arsyeshmëri të plotë, për anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Valentin Krasniqi: Këta regjistra janë publikë, të gjitha këto prona gjenden në gjeo-portal, sqaroi edhe sistemin e Kcidit në aparatit kadastral, lidhur me pronat dhe evidencat e tyre. Tani ka nisur një punë në bashkëpunim edhe me Zyrën e Kryeministrit, për dixhitalizimin e pronave, për ta pasur

një sistem unik të pronave, në këtë punë jemi duke punuar Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Kryetari i Komunës: Propozimi për shpalljen e interesit publikë për këto prona nën menaxhimin e Agjensisë Kosovare të Privatizimit, i kemi analizuar dhe janë shumë të nevojshme, për realizimin e projekteve me interes publik për qytetarët e komunës tonë në të ardhmen, ka edhe procedura tjera në vazhdim, ku hyn edhe pagesa e shumës prej 20% për secilën pronë, që shpronësohet në dobi të komunës, apo mund të merret edhe ndonjë vendim i Qeverisë së Kosovës për marrjen në shfrytëzim të këtyre pronave, që për ne janë të domosdoshme për ndërtimin e çerdheve, shkollave, objekteve shëndetësore, kulturore, sportive, apo edhe për shërbime publike tjera, andaj ju ftoi që ta përkrahni këtë propozim, jemi në dispozicion për të dhënë sqarime shtesë, edhe në periudhën e ardhshme, kur do që na kërkohet.

Pati edhe diskutime dhe sqarime tjera, pas të cilave Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimit për shpalljen e interesit publik për Ngastrat Kadastrale në Zonat Kadastrale të territorit të Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shpalljen e interesit publik për Ngastrat Kadastrale në Zonat Kadastrale të territorit të Komunës së Fushë-Kosovës', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për shpalljen e interesit publik për Ngastrat Kadastrale në Zonat Kadastrale të territorit të Komunës së Fushë-Kosovës'.

Pika e tretë (3) - Propozim për ndihmë financiare të fëmijëve me autizëm dhe sindromin doën.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndihmë financiare të fëmijëve me autizëm dhe sindromin doën', ftoi Kryetarin e Komunës që të na jap sqarime.

Kryetari i Komunës: Propozimi për përkrahjen e fëmijëve me autizëm dhe sindromin doën, është i arsyeshëm, sepse familjet e tyre kanë shumë shpenzime, andaj ne kemi vendosur që t'i përkrahim me shumën e mjeteve financiare prej: 100.00€ në muaj, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, do të punojmë edhe për ndërtimin e një 'Qendre për trajtimin e këtyre fëmijëve', këtu ideja është për të krijuar lehtësime për këta fëmijë, përmes aktiviteteve, ditore, me këtë punë është duke u marrë znj. Ganimete Berisha dhe z. Rexhep Gojnovci, ku pritet të na përkrah edhe KFOR-i slloven.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes vetëvendosje, pajtohemi që propozimi në fjalë, të procedohet për shqyrtim në kuvendin e Komunës.

Ali Ismaili: Ky është një propozim i qëlluar dhe ne e mbështesim, por do të ishte mirë, që ta kemi një listë të këtyre fëmijëve, që duhet të përkrahen nga subvencionet e komunës.

Kryetari i Komunës: Jemi duke e bërë këtë data-bazë, njëherë i kemi evidentuar 75 fëmijë, në një listë tjetër janë 129 fëmijë, do ta bëjmë një verifikim përfundimtarë dhe do të ju informojmë. Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimit për ndihmë financiare të fëmijëve me autizëm dhe sindromin doën'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për ndihmë financiare të fëmijëve me autizëm dhe sindromin doën’, me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të ‘Propozimit për ndihmë financiare të fëmijëve me autizëm dhe sindromin doën’, me shumën e mjeteve financiare prej: 100.00 € në muaj dhe realizimin e pagesave të tyre cdo tre muaj nga kategoria e subvencioneve në shëndetësi.

Pika e katërt (4) - Raporti i Auditimit të jashtëm për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim ‘Raportin e Auditimit të jashtëm për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2024’.

Kryetari i Komunës: Këtu duhet të marrim masa për përmirësimin e performancës.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim, analizim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Raportin e Auditimit të jashtëm për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2024’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe [Financa e aprovoi për procedim, analizim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Raportin e Auditimit të jashtëm për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2024’](#), me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim, shqyrtim dhe analizim në Kuvendin e Komunës të ‘Raportit të Auditimit të jashtëm për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2024’.

Pika e pestë (5) - Raporti i Auditimit të performancës në procesin e lejeve ndërtimore në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim ‘Raportin e Auditimit të performancës në procesin e lejeve ndërtimore në Komunën e Fushë-Kosovës’. Hap diskutimin.

Kryetari i Komunës: Është skandaloze, ato gjetje që janë bërë nga Zyra Kombëtare e Auditimit, në procesin e lëshimit të lejeve ndërtimore, kemi shumë probleme, as projektet kapitale të komunës nuk kanë leje ndërtimore, kemi kërkuar auditime të veçanta në shumë fusha nga Zyra Kombëtare e Auditimit, edhe për ndarjen e subvencioneve, të cilat janë bërë pa kritere, të ditura paraprakisht nga aplikuesit.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim, analizim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Raportin e Auditimit të performancës në procesin e lejeve ndërtimore në Komunën e Fushë-Kosovës’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa e aprovoi për procedim, analizim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Raportin e Auditimit të performancës në procesin e lejeve ndërtimore në Komunën e Fushë-Kosovës’, me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim, shqyrtim dhe analizim në Kuvendin e Komunës të ‘Raportit të Auditimit të performancës në procesin e lejeve ndërtimore në Komunën e Fushë-Kosovës’.

Pika e gjashta (6) - Informatë për Performancën Komunale në vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim ‘Informatën për Performancën Komunale në vitin 2024’, nga shqyrtimi i saj në Kuvendin e Komunës, fitojmë pikë shtesë në raportin e performancës komunale.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim, analizim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Informatën për Performancën Komunale në vitin 2024’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa e aprovoi për procedim, analizim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Informatën për Performancën Komunale në vitin 2024’, me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim, shqyrtim dhe analizim në Kuvendin e Komunës të ‘Informatës për Performancën Komunale në vitin 2024’.

Pika e shtatë (7) - Propozim për shqyrtimin e Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Sqaroi se propozimet për planin vjetor të punës janë të inkorporuara në plan, nëse nuk keni ndonjë plotësim ju ftoi që ta procedojmë për shqyrtim dhe aprovim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për Projekt-Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026’.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimit për shqyrtimin e Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për shqyrtimin e Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026’, me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të ‘Propozimit për shqyrtimin e Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026’.

Pika e tetë (8) - Propozim për themelimin e Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani i kemi gjashtë pika për themelimin e Komiteteve të Kuvendit të Komunës, duke filluar nga Propozimi për themelimin e Komitetit për Komunitete, propozimi i emrave nga subjektet politike, do të jepet në mbledhjen e Kuvendit të Komunës për secilin komitet.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimit për themelimin e Komitetit për Komunitete’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Komunitete’, me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të ‘Propozimit për themelimin e Komitetit për Komunitete’.

Pika e nëntë (9) - Propozim për themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik.

Kryesues i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik’.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik’, me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të ‘Propozimit për themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik’.

Pika e dhjetë (10) - Propozim për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Kadastër Shërbime Publike dhe Mbrojtje e Mjedisit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Kadastër Shërbime Publike dhe Mbrojtje e Mjedisit’. Hap diskutimin.

Dardane Sogojeva Shala: Propozoi që në këtë komitetë të hyn edhe Infrastruktura.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Kadastër Infrastrukturë Shërbime Publike dhe Mbrojtje e Mjedisit’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Kadastër Infrastrukturë Shërbime Publike dhe Mbrojtje e Mjedisit’, me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të ‘Propozimit për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Kadastër Infrastrukturë Shërbime Publike dhe Mbrojtjen e Mjedisit’.

Pika e njëmbëdhjetë (11) - Propozim për themelimin e Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport’. Hap diskutimin.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport’.

U votua unanimitisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport’, me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të ‘Propozimit për themelimin e Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport’.

Pika e dymbëdhjetë (12) - Propozim për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale’. Hap diskutimin.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale’.

U votua unanimitisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale’, me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të ‘Propozimit për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale’.

Pika e trembëdhjetë (13) - Propozim për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra’. Hap diskutimin.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra’.

U votua unanimitisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra’, me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të ‘Propozimit për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra’.

Pika e katërbëdhjetë (14) - Propozim për shqyrtimin e Kërkesës Nr. 01-104/02-0004317/26, të datës 10.02.2026 për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë, të parashtruar me Nr. 01-104/02-0004317/26, të datës 10.02.2026 për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2026, po ashtu duhet të aprovojmë edhe kërkesën e komunitetit ortodoks. Hap diskutimin.

Kryetari i Komunës: Ne mendojmë se një pjesë të punëve për ceremonitë e varrimit, do t'i realizojmë në të ardhmen, nga ana e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova, në fshatin Bardh i Madh, e kemi të zgjidhur këtë punë, por është duke u diskutuar që të gjindet një zgjidhje edhe nga niveli qendror

Pati edhe diskutime dhe sqarime tjera pas të cilave, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e Kërkesës Nr. 01-104/02-0004317/26, të datës 10.02.2026, kërkesën e komunitetit ortodoks për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2026'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e Kërkesës Nr. 01-104/02-0004317/26, të datës 10.02.2026, kërkesën e komunitetit ortodoks për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2026', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për shqyrtimin e Kërkesës Nr. 01-104/02-0004317/26, të datës 10.02.2026 dhe kërkesën e komunitetit ortodoks, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2026'.

Pika e pesëmbëdhjetë (15) - Propozim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029', lexoi emrat sipas udhëzimit administrativ dhe hapi diskutimin.

Pasi që diskutime nuk pati, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa u pajtuan që kjo punë është e rregulluar me udhëzimin administrative të vitit 2012, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim 'Propozimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029', me emrat e cekur si vijon: Valon Prebreza - Kryetari i Komunës, Bekim Zogjani - Komandanti i Stacionit Policor, përfaqësuesi i Këshillit të Bashkësisë Islame, përfaqësuesi i Kishës ortodokse-serbe, përfaqësuesit e komuniteteve ashkali, egjiptian, serbë dhe romë, Adriatik Zeqiri - Drejtori për arsim, Izja Mjeku - Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis, Ejup Qyqalla - përfaqësues i emergjencave civile, një përfaqësues i EVSB-së, nga një përfaqësues i KLSP-ve, Lindita Dervisholli Prebreza - Zyrtarja për Barazi Gjinore, Slagjana Llazic - Shefja e Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, nga një përfaqësues i mediave, bizneseve, personave me aftësi të kufizuara dhe shoqërisë civile.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029, me emrat e cekur më lartë' dhe mori këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin 2025-2029', në përbërje si vijon: Valon Prebreza - Kryetari i Komunës, Bekim Zogjani - Komandanti i Stacionit Policor, përfaqësuesi i Këshillit të

Bashkësisë Islame, përfaqësuesi i Kishës ortodokse-serbe, përfaqësuesit e komuniteteve ashkali, egjiptian, serbë dhe romë, Adriatik Zeqiri - Drejtori për arsim, Izja Mjeku - Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis, Ejup Qyqalla - përfaqësues i emergjencave civile, një përfaqësues i EVSB-së, nga një përfaqësues i KLSP-ve, Lindita Dervisholli Prebreza - Zyrtarja për Barazi Gjinore, Slajana Llazic - Shefja e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, nga një përfaqësues i mediave, bizneseve, personave me aftësi të kufizuara dhe shoqërisë civile.

Pika e gjashtëmbëdhjetë (16) - Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: A keni dikush për të shtruar ndonjë çështje për diskutim. Nëse jo atëherë falënderit shumë, shihemi në mbledhjen e radhës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 11:40 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

